



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 84 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 22 / 08 / 2022

VENDIM

Nr.22, date 22 /08/2022

PËR

PROJEKTIN E ZBATIMIT PER REHABILITIMIN EMERGJENT TE DIGES SE CERKEZES,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 22.08.2022 mori në shqyrtim Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Tiranë në lidhje me Rehabilitimin emergjent të digës së Cerkezës. Dokumentacioni teknik i dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë llogaritjet e qendrueshmerise statike dhe dinamike të digës, raportin gjeologo inxhinierik, sizmik, gjeodezik, hartat e përmytjeve dhe planin e gadishmërise në rastet e emergjencave civile për shkak të përdorimit të diges. Njekohesisht, Në kete dokumentacion përfshihet edhe Oponenca e kryer nga Instituti i ndertimit i cili ka arritur në konkluzionin se Projekti i plotëson kushtet teknike për zbatimin e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur dhe sipas perfaqësuesit të Bashkisë, rezultojnë se gjendja aktuale e elementeve kryesore të digës është problematike dhe ka nevojë për rehabilitim të diges, kryesisht në forcim të anës së sipërme dhe të poshtme të digës. Në projekt është parashikuar edhe instalimi i sistemeve të monitorimit gjeodezik dhe hidraulik të saj. Nga matjet batimetrike të paraqitura, rezultojnë që rezervuari ka një volum aktual prej 3.8 milion m³ ujë. Njekohësisht rezultojnë që në zonën urbane poshtë digës janë në rrezik, në rast të prishjes së mundshme të digës, afro 5000 njerëz.

Pas diskutimeve të të gjitha antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Tiranë për Rehabilitimin emergjent të digës së Cerkezës.
- 2- Ti kërkojë Bashkisë Tiranë të informoj KKDM për fillimin e punimeve dhe caktimin e Mbikqyresit të punimeve sipas kërkesave të VKM së mesiperme, neni 20 dhe neni 21;
- 3- Ti kërkoj Bashkisë Tiranë që të pregatit dhe të dorëzoj pranë KKDM rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës së Cerkezës sipas Nenit 29 të VKM së mesiperme dhe Vendimit të KKDM Nr.3, datë 09.10.2020 "Udhëzues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave"
- 4- Bazuar në rezultatet e këtij projekti në lidhje me hartën e përmytjeve dhe banorët që janë në rrezik në zonën urbane poshtë digës, Bashkia Tiranë duhet të parashikoj hartimin e një projekti zbatimi për instalimin e sistemit të alarmi në digë dhe në zonën urbane poshtë saj sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

